L I G J
Nr.8191, datë 6.2.1997

PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1700, DATË 9.1.1997 "PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7777, DATË 22.12.1993 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet me ndryshime dekreti nr.1700, datë 9.1.1997 "Për një ndryshim në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", si vijon:

Në nenin 2, rreshti i tretë ndryshohet:

"Për autovetura dhe mjete të tjera për transportin e jo më shumë se 10 personave, mikrobuzë, furgonë dhe mjete të tjera për transportin e mallrave me peshëmbajtje deri në 5 ton caktohet 20 000 lekë".

Në nenin 2, rreshti i katërt, ndryshohet: "Për traktorët rrugorë (kokat tërheqëse), autobuzët dhe mjete të tjera për transportin e mallrave me peshëmbajtje mbi 5 ton, caktohet 20 000 lekë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1721, datë 11.2.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha